

V E N D I M
Nr.25, datë 20.1.2001

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.248, DATË 10.4.1998, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E PLANIT KONTABËL PUBLIK, PËR ORGANET E PUSHTETIT LOKAL, INSTITUCIONET SHTETËRORE, QENDRORE DHE LOKALE, SI DHE TË NJËSIVE QË VAREN PREJ TYRE".

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, 5, 74 të ligjit nr. 7661, datë 19.1.1993 "Për kontabilitetin", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

Në vendimin nr.248 datë 10.4.1998, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në titullin e projektit dhe kudo në vendim fjala "... lokale..." ndryshohet dhe zëvendësohet me fjalën "... vendore..."

2. Në Planin Kontabël Publik të organeve të pushtetit vendor, të institucioneve shtetërore, qendrore dhe vendore, si dhe të njësive që varen prej tyre, bëhen shtesat dhe ndryshimet sipas materialit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Pas pikës 6 shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje :

" 6/1. Organet e qeverisjes vendore duhet të depozitojnë llogaritë vjetore në Ministrinë e Pushtetit Lokal. Degët e thesarit në rrethe, dorëzojnë, në Ministrinë e Pushtetit Lokal, një kopje të llogarisë përmbledhëse vjetore për organet e qeverisjes vendore."

4. Në pikën 7, pas fjalëve "Ngarkohet Ministria e Financave ..." shtohen fjalët "... të përcaktojë modelin e pasqyrave financiare dhe aneksin e llogarisë vjetore të subjekteve, që i nënshtrohen këtij vendimi dhe ...".

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

NDRYSHIME E SHTESA NE PLANIN KONTABEL PUBLIK
TE ORGANEVE TE PUSHTETIT LOKAL,
INSTITUCIONEVE SHTETERORE QENDRORE DHE LOKALE,
SI DHE TE NJESIVE QE VAREN PREJ TYRE"

Ne Planin Kontabel Publik te organeve te pushtetit lokal, institucioneve shteterore qendrore dhe lokale, si dhe te njesive qe varen prej tyre, te miratuar me vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 248, date 10.04.1998, kryhen shtesa dhe ndryshime si me poshte:

1. Struktura e llogarive te Planit Kontabel Publik dhe funksionimi i llogarive kontabel eshte i njejte per te gjithë subjektet qe i nenshtrohen zbatimit te vendimit nr.248, date 10.04.1998.

2. Nga struktura e pergjithshme, subjektet e mesiperme te perdorin llogarite kontabel, qe jane te nevojshme per ushtimin normal te veprimtarise se tyre.

3. Ne Planin Kontabel Publik shprehjet "organizmat lokale" dhe "organet e pushtetit lokal" zevendesohen me shprehjen " subjektet qe i nenshtrohen mbajtjes se Planit Kontabel Publik" . Ne kete vendim per shkurtim eshte perdorur termi "institucion".

4. Ne faqen 8, pika b, paragrafi 1, te hiqet shprehja "(llogarite e klases 7)" ; ne paragrafin 2 te hiqet shprehja "(Llogarite e klases 6)";

5. Ne faqen 9, pika d, paragrafi 1, shtohet fraza "Struktura e Llogarive te Planit Kontabel Publik qe evidenton sipas natyres operacionet buxhetore te institucionit, ndertohet ne perputhje me klasifikimin buxhetor ne nivel artikulli". Ne strukturen e llogarive kontabel te institucioneve, bashkelidhur ketij vendimi, jepen me shkronja italiane llogarite e Planit Kontabel Publik te ndryshuara me kete vendim.

6. Ne faqen 9, pika f, paragrafi 2, shprehja "...Nenllogaria shtjellohet ne analiza 5 shifrore..."

zevendesohet me "...Nenllogaria shtjellohet ne analiza 7 shifrore te rendit rrites..." dhe te shtohet fraza "Ndryshimet dhe shtesat ne nomenklaturen e llogarive jane kompetence e ministrit te Financave".

7. Ne faqen 69, pika 1.a, paragrafi i pare, pas shprehjes "formati tip i urdhrimit per shpenzim...." shtohet "...si dhe procedurat e regjistrimit , qarkullimit dhe të ruajtjes se ketij dokumenti...."

8. Ne faqen 70, pika 1.b, paragrafi i pare, pas shprehjes "formati tip i titullit per te ardhurat...." shtohet "...si dhe procedurat e regjistrimit , qarkullimit dhe ruajtjes se ketij dokumenti...."

9. Ne faqen 71, pika 2A.a, shtohet paragrafi i pare "Per ekzekutimin e shpenzimeve te urdheruara, perpilohet dokumenti urdher-pagese i cili dorezohet per miratim ne organet e Thesarit. Formatit tip i urdher-pageses, procedurat e regjistrimit, qarkullimit dhe të ruajtjes se ketij dokumenti jepen me udhezim te ministrit te Financave"

10. Ne faqen 71, pika 2A.b, paragrafi i dyte, pas shprehjes "Kjo procedure perdoret zakonisht kur organet e pushtetit lokal..." shtohet "...dhe institucionet buxhetore nacionale kryejne shpenzime te vogla brenda limitit te arkës, si dhe"

11. Ne faqen 72, pika 2B.b, shtohet nje paragraf si vijon: "“Ne llogarine 487 “Te ardhura te arketuara para titullit” regjistrohen gjithashtu ne momentin e arketimit te ardhurat aksidentale te arketuara nepermjet arkës. Ne fund te dites ose te javes (ne vartesi te fluksit te te ardhurave), perpilohet nje liste arketimi e emertuar “Titull per konstatimin e te ardhurave”, e firmosur nga urdheruesi. Dy kopje te titullit shoqerojne derdhjen e te ardhurave ne llogarine e institucionit prane Thesarit.Formati tip i titullit per konstatimin e te ardhurave, procedurat e regjistrimit , qarkullimit dhe te ruajtjes se ketij dokumenti jepet me udhezim te ministrit te Financave.

Pas konfirmes se Thesarit te shoqeruar me origjinalin e titullit liste (te vulosur nga Thesari) kontabilisti procedon me marrjen ne ngarkim te te ardhurave duke debituar llogarine 487 ne kredi te llogarise perkatese te te ardhurave.

12. Ne faqen 32, klasa 1 “Fonde te veta, hua dhe detyrime te ngjashme afatgjate”:

- Llogaria 1050 “Fonde baze” ndryshon ne “Llogaria 1010- fonde baze”. Kjo llogari pasqyron vleren neto te pasurise se Institucionit ne momentin e kalimit ne sistemin e kontabilitetit te ri publik me 31.12.1998.

- Shtohet llogaria 1011 “Shtesa mbi fondin baze”. Kjo llogari merr ne kredi shtesat mbi fondin baze pas dates 1 janar 1999:

mbetjen kreditore te llogarise 116 “Te ardhura nga shitja e aktiveve te qendrueshme” ne fund te vitit;

ndikimin pozitiv ne fund te vitit te ndryshimit te gjendjeve te inventarit ne debi te llogarise 842 “Transferimi i te ardhurave”;

shumat qe rezultojne si teprica inventari ne debi te llogarive perkatese te aktiveve te qendrueshme.

- Shtohet llogaria 1012 “Pakesime te fondit baze” e cila funksionon ne debi per pakesimet e fondit baze pas dates 1 janar 1999:

per mbetjen debitore ne fund te vitit te llogarise 116 “Te ardhura nga shitja e aktiveve te qendrueshme”;

per vleren neto te aktiveve te qendrueshme, te dhena falas te treteve, te nxjerra jashte perdorimit apo te humbura;

per ndikimin negativ te ndryshimit te gjendjeve ne fund te vitit ne kredi te llogarise 841 “Transferim shpenzimesh”;

- Shtohet llogaria 1013 “Konsumi i aktiveve te qendrueshme”, llogari e cila zevendeson llogarine 108 me te njejtin emertim. Kjo llogari pasqyron ne debi kunderpartine e amortizimit te aktiveve te qendrueshme te institucionit - llogarite 219.

- Hiqet paragrafi i fundit ne llogarine 10 – Fonde te veta “Ne fund te vitit, normalisht keto llogari duhet te integrohen ne llogarine 1050 “Fonde baze”.

Llogarite 105 dhe 106 ristrukturohen dhe riemertohen, perkatesisht 105 “Grante te brendshme kapitale” dhe 106 “Grante te jashtme kapitale”. Keto llogari kreditohen, gjate vitit, per financimet dhe grantet per investime te marra ne likuiditete ose ne natyre me kunderparti llogarine 520 “Disponibilitete ne Thesar” ose llogarite perkatese te aktiveve te qendrueshme, sipas rastit. Keto llogari debitohen ne fund te vitit per fondet per investime ne proces (te pakapitalizuara), ne kredi te llogarive perkatese 140 “Pjesemarrje ne investime per llogari te institucionit”ose 141”Pjesemarrje ne investime per llogari te te treteve”, sipas rastit (operacion jobuxhetor). Ketu perjashtohen fondet e

financuara nga buxheti i shtetit, te cilat jane regjistruar gjate vitit ne llogarine 476 “Te ardhura te percaktuara per t’u perdorur”. Periodikisht dhe ne fund te vitit llogaria 476 debitohet ne kredi te llogarise 105 “Grante te brendshme kapitale” ose llogarive te grupit 14 “Pjesemarrje te institucionit ne investime” per shumen e fondeve te buxhetit, te shpenzuara per investime gjate periudhes.

- Ne pershkrimin e funksionimit te llogarise 106, shtohet fjalia “- ne debi te llogarise 520 “Disponibilitete ne Thesar” per grantet ne likuiditete”.

- Hiqet paragrafi i fundit ne llogarine 106 : “Llogaria 106 debitohet me perfshirjen e ndihmave ne llogarine e fondeve baze - llogaria 1050 “Fonde baze”.

- Llogaria 107 riemertohet “Aktive te qendrueshme te caktuara ne perdorim”. Ne faqen 34, termi “Kunderpartine” zevendesohet me “vleren neto”.

- Llogaria 111, faqe 34, percaktohet “Fonde rezerve per shpenzime korrente”.

- Llogaria 116, faqe 35, emertohet “Te ardhura nga shitja e aktiveve te qendrueshme”, si dhe ristrukturohet. Funksionimi i kesaj llogarie percaktohet si vijon: Llogaria 116 pasqyron ne kredi:

- operacionet buxhetore per te ardhurat nga shitja e aktiveve te qendrueshme te institucionit (cmimi i shitjes) ne debi te llogarive te te treteve ose financiare;

- mbetjen debitore te kesaj llogarie, ne fund te vitit, ne debi te llogarise 1012 “Pakesime te fondeve baze” (operacion jobuxhetor).

- Kjo llogari debitohet:

- per vleren neto te aktiveve te qendrueshme te shitura (operacion jobuxhetor) ne kredi te llogarive perkatese te aktiveve te qendrueshme;

- periodikisht ose ne fund te vitit per shumen e derdhur ne buxhet nga te ardhurat e krijuara (konform akteve ligjore e nenligjore ne fuqi), ne kredi te llogarise 520 “Disponibilitete ne Thesar”;

- ne fund te vitit per mbetjen kreditore qe rezulton ne kete llogari ne kredi te llogarise 1011 “Shtesa te fondeve baze”.

- Llogarite e grupit 14 “Pjesemarrje te institucionit ne investime”, faqe 37, riemertohen ne llogarine 140 “Pjesemarrje ne investime per llogari te institucionit” dhe 141 “Pjesemarrje ne investime per llogari te te treteve”. Keto llogari pasqyrojne ne kredi financimet per investime te paperfunduara, duke debituar llogarite e financimeve 105 (operacione jobuxhetore). Keto llogari debitohen per vleren e aktiveve te qendrueshme te perfunduar dhe te dorezuara ne kredi:

- te llogarise 23 “Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme” per vleren e aktiveve te krijuara per te trete;

- te llogarive 105 ose 106 sipas rastit per aktivet e marra ne dorezim ne institucion.

- Llogaria 16 (faqe 39) “Huamarrje te brendshme afatmesme dhe afatgjate” ristrukturohet. Ky grup llogarish funksionon ne kredi (llogarite 160 -164) per arketimin e huase se kontraktuar dhe ne debi (llogarite 165 -169) per shlyerjen e keseteve te principialit te huase se marre me kunderparti llogarite e te treteve ose financiare.

- Shtohet llogaria 17 “Huamarrje te jashtme” funksionimi i te ciles eshte i njejte me llogarine 16.

13. Ne faqen 40 , klasa 2 “Aktive te qendrueshme” percaktohet ne perberje si me poshte:

- Llogarite e administrimit te aktiveve te qendrueshme perkatesisht llogarite 20 “Aktive te qendrueshme te patrupezuara”, llogarite 21 “Aktive te qendrueshme te trupezuara”, llogarite 25 “Huadhenie dhe nenhuadhenie”, 26 “Pjesemarrje ne kapitalin e vet” llogarite 24 “Aktive te qendrueshme te trupezuara te demtuara”, llogarite 28 “Caktime” dhe llogarite 29 “Zhvleresimi i aktiveve te Qendrueshme”;

- Llogarite e regjistrimit te operacioneve buxhetore te shpenzimeve per blerjen, krijimin dhe shtimin e aktiveve te qendrueshme perkatesisht llogarite 23 “Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme”, llogarite 25 “Huadhenie dhe nenhuadhenie”, llogarite 26 “Pjesemarrje ne kapitalin e vet”;

- Ne pershkrimin e llogarise 20 – “Aktive te patrupezuara”, faqe 41, paragrafi i pare shtohen fjalet “...ne kredi te llogarise perkatese 23.”

- Ne pershkrimin e llogarise 20 – “Aktive te patrupezuara” paragrafi i dyte shtohet pas fjalise se pare. “Per institucionet me karakter administrativ amortizimi i aktiveve te patrupezuara pasqyrohet sipas metodës se rendit ne debi te llogarise 1013 “Konsumi i aktiveve te qendrueshme”. E njejta fjali shtohet ne pershkrimin e funksionimit te llogarise 209 “Amortizimi i aktiveve te qendrueshme, te patrupezuara”.

- Llogaria 203 dhe 204 nuk perdoren.
- Ne pershkrimin e funksionimit te llogarive 21 “Aktive te qendrueshme te trupezuara”, skema e shitjes se aktivitet te qendrueshem (faqe 44) ndryshon si vijon:

- Per dorezimin e aktivitet (ne baze te aktit te dorezimit ose fletedaljes)

- * llogaria perkatese e aktivitet (grupi 21) kreditohet per vleren bruto te aktivitet ne debi te llogarise se amortizimit perkates – llogarite 219 per amortizimin e akumuluar te saj, dhe ne debi te llogarise 116 “Te ardhura nga shitja e AQ” per vleren e mbetur te aktivitet.

- Per konstatimin e te ardhurave nga shitja (ne baze te fatures se shitjes dhe titullit te te ardhurave bashkengjitur)

- * kreditohet llogaria 116 “Te ardhura nga shitja e aktiveve te qendrueshme” ne debi te llogarise 411 “Kliente”.

- Ne pershkrimin e funksionimit te llogarive 21 “Aktive te qendrueshme te trupezuara”, skema e blerjes se aktivitet te qendrueshem (faqe 43) ndryshon si vijon: “ Operacioni buxhetor i blerjes (me dokumentet justifikues dhe urdher shpenzimit bashkengjitur) pasqyrohet ne debi te llogarise perkatese 23 “Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme” dhe ne kredi te llogarise 404 “Furnitore per aktive te qendrueshme”. Fakti i hyrjes ne institucion ose i marrjes ne dorezim te aktivitet te qendrueshem pasqyrohet (ne baze te fletehyrjes ose te marrjes ne dorezim) ne debi te llogarise perkatese te aktivitet 21 dhe ne kredi te llogarise perkatese 23.

- Strukturimi i llogarise 23 “Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme”(faqe 45) si dhe pershkrimi i funksionimit te saj ndryshon si vijon: “Kjo llogari regjistron ne debi operacionet buxhetore per blerjen, krijimin dhe shpenzimet shtese (rikonstruksionet dhe permiresimet qe cojne ne rritjen e vleres se aktiveve te qendrueshme te trupezuara), duke kredituar llogarite e te treteve, financiare ose llogaritë 782 “Punime ne ekonomi” sipas rastit. Ajo kreditohet me hyrjen efektive te aktiveve ne institucion, ose me marrjen ne dorezim te aktiveve te perfunduara, ne debi te llogarive perkatese te aktiveve te qendrueshme. Gjithashtu llogaria 23 kreditohet ne debi te llogarive 105 “Grante te brendshme”, 106 “Grante te huaja”, 14 “Pjesemarrje te institucionit ne investime” per dorezimin e aktiveve te krijuara nga institucioni per te trete.

- Ne fund te vitit teprica debitore e kesaj llogarie jep shumen e investimeve te paperfunduara ose te pa bera hyrje ne institucion.

- Ne pershkrimin e llogarise 24 “Aktive te qendrueshme te trupezuara te demtuara” (faqe 46) percaktohet “Llogaria 24 pershkruan operacionet lidhur me aktivet e trupezuara te demtuara qe ndodhen ne magazine perkohesisht ose teresisht jashte perdorimit deri ne venien perseri ne perdorim pas rikonstruksionit ose daljen jashte perdorimit te tyre. Kjo llogari

- a) debitohet per vleren kontabel neto te aktivitet te trupezuar te demtuar ne kredi te llogarive perkatese te grupit te llogarive 21 “Aktive te trupezuara”;

- b) debitohet per vleren e rikonstruksionit ose punimeve shtese ne kredi te llogarive perkatese 23;

- c) kreditohet per vleren e mbetur ne debi te llogarise 1011 “Pakesime te fondit baze” per daljen jashte perdorimit te aktivitet;

- d) kreditohet per vleren e krijuar, ne debi te llogarive perkatese 21 me kalimin e aktivitet ne perdorim pas rikonstruksionit.

- Llogarite 25 (faqe 46) ristrukturohen ne perputhje me klasifikimin buxhetor (nomenklatura bashkengjitur). Llogarite 250, 251 regjistrojne, ne kredi, operacionet buxhetore te arketimit te principialit te huase se dhene te treteve. Llogarite 255 deri 259 regjistrojne ne debi operacionet buxhetore te dhenies se huase te treteve. Si kunderparti sherbejne llogarite e te treteve ose financiare.

- Llogarite 26 “Tituj dhe vlere” (faqe 47) ristrukturohen ne perputhje me klasifikimin buxhetor (nomenklatura bashkengjitur). Llogarite 260, 261 262, 264 regjistrojne ne kredi operacionet buxhetore te arketimit te te ardhurave nga shitja e titujve te portofolit. Llogarite 265 deri 269 rregjistrojne ne debi operacionet buxhetore te blerjes se titujve te portofolit.

- 14. Ne faqen 49, llogarite e klases 3 “Llogarite e gjendjeve te inventarit dhe te prodhimit ne proces”, perkatesisht llogarite 312 “Materiale te tjera” dhe 32 “Objekte inventari” ristrukturohen ne perputhje me riorganizimin e llogarive te shpenzimeve per materiale – llogaria 602 “Mallra dhe sherbime te tjera”. Funksionimi i llogarive te kesaj klase nuk ndryshon.

- 15. Ne faqen 50, klasa 4 “Llogarite e te treteve” riemertohet “Llogarite e marrëdhënieve me te tretet”. Funksionimi i disa llogarive ndryshon si vijon:

- Menyra e konstatimit te detyrimit te institucionit ndaj personelit. Te gjitha ndalesat nga paga bruto e punonjesve pasqyrohen ne debi te llogarise 600 "Paga, shperblime dhe shpenzime te tjera personeli", me kunderparti llogarite perkatese te te treteve per te cilet eshte bere ndalesa. Perkatesisht:

- Llogaria 421 "Personeli- paga per t'u paguar" dhe 425 "Personeli-shperblime per tu paguar" merr ne kredi detyrimet e institucionit ndaj personelit per shumen neto te tyre ne debi te llogarise se shpenzimeve 6001 "Paga te personelit te perhershme" dhe 6009 "Shpenzime te tjera – shperblime".

- Ne llogarine 423 "Paradhenie personelit" pas fjaleve "...per shlyerjen nepermjet ndalesave nga paga..." shtohet shprehja "..., per shlyerjen nepermjet dokumenteve justifikues te pagesave me leke ne dore,..."

- Në llogarinë 427 "Ndalesa nga paga per detyrime ndaj te treteve" zevendesohen fjalet "..., ne debi te llogarise 421 "Pagat e personelit"." me "..., ne debi te llogarise "Shpenzime per paga"."

- Në llogarinë 429 "Deficite dhe gjoba personale" shtohet paragrafi i dyte "..., ose ne debi te llogarise "Humbje nga mosarketimi i te ardhurave" per kalimin ne shpenzime te tyre me vendim te organit kompetent.";

- Ne llogarine 4311 "Te drejta dhe taksa per tu derdhur ne Shtet" shtohet paragrafi i trete "Kjo llogari kreditohet per marrjen ne ngarkim te detyrimit per derdhjen e tatimeve mbi te ardhurat e personelit ne debi te llogarise "Shpenzime per paga personeli dhe kreditohet per shlyerjen e detyrimit ne kredi te llogarise se Thesarit.";

- Në llogarinë 435 "Sigurime shoqerore" dhe 436 "Sigurime shendetesore" zevendesohet shprehja "(llogaria 421).." me "(llogaria 6001 "Paga te personelit te perhershme")..."

- Llogaria 434 "Marrdhenie me Shtetin" funksionon me dy nenllogari perkatesisht:

a) 4341 "Marrdhenie me shtetin – Kreditor" e cila pasqyron detyrimet e institucionit kundrejt shtetit nga te ardhurat per tu arketuuar. Kjo llogari kreditohet ne fund te periudhes ushtrimore ne debi te llogarise 842 "transferim i te ardhurave" dhe debitohet me derdhjen efektive te te ardhurave ne buxhet ne kredi te llogarise 520 "Disponibilitete ne Thesar".

b) 4342 "Marrëdhënie me Shtetin debitor", e cila pasqyron te drejtat e institucionit kundrejt shtetit per detyrime ndaj te treteve per tu paguar me fonde buxhetore ne periudhat ushtrimore pasardhese . Kjo llogari debitohet ne fund te periudhes ushtrimore ne kredi te llogarise 841 "Transferim i shpenzimeve" dhe kreditohet paralelisht me likuidimin faktik te detyrimeve ndaj te treteve, ne debi te llogarise 476 "Te ardhura te caktuara per tu perdorur".

16. Ne faqen 61, klasa 5 "Llogarite financiare" ndryshon si vijon:

- Llogaria 568 "Disponibilitete ne Thesar" zevendesohet me llogarine 520 "Disponibilitete ne Thesar". Kjo llogari, e ndertuar per te pasqyruar marrdheniet e institucionit me sistemin e Thesarit, regjistron te gjithë pagesat dhe arketimet e institucionit ne llogarine tij ne Thesar.

17. Ne faqen 62 , klasa 6 "Shpenzime sipas natyres" strukturohet ne nivel grupi llogarish si me poshte:

60 – "Shpenzime korrente". Ky grup llogarish eshte i strukturuar ne nivel llogarie, nenllogarie dhe analize sipas klasifikimit buxhetor. Ne baze te dokumenteve justifikues te shpenzimit bashkengjitur urdherit te shpenzimit te nxjerre nga urdheruesi, ne keto llogari regjistrohen ne debi operacionet buxhetore te shpenzimeve sipas natyres, duke kredituar llogarite e marrdhenieve me te tretet ose financiare sipas rastit.

63 – "Ndryshimi i gjendjeve te inventarit". Ky grup regjistron operacione jobuxhetore dhe zevendeson llogarine 603 "Ndryshimi i gjendjeve". Funksionimi i llogarive te ketij grupi nuk ndryshon.

64 – "Shpenzime ne natyre". Ky grup regjistron kunderpartine e financimit apo transferimit ne natyre te aktiveve qarkulluese te institucionit nga institucione brenda ose jashte sistemit (operacion jobuxhetor). Ky operacion kryhet paralelisht me regjistrimin e hyrjeve te materialeve ne magazinën e institucionit marres ne debi te llogarise 64 dhe ne kredi te llogarise 74 "Financime ne natyre".

65 "Shpenzime financiare te brendshme" dhe 66 "Shpenzime financiare te jashtme". Ky grup llogarish eshte i strukturuar ne nivel llogarie, nenllogarie dhe analize sipas klasifikimit buxhetor. Ne baze te dokumenteve justifikues te shpenzimit, bashkengjitur urdherit te shpenzimit te nxjerre nga urdheruesi ne keto llogari regjistrohen, ne debi, operacionet buxhetore te shpenzimeve financiare sipas natyres, duke kredituar llogarite e marrdhenieve me te tretet ose financiare sipas rastit.

67 – "Shpenzime te jashtezakonshme".Ne kete grup llogarish regjistrohen operacione

jobuxhetore qe i perkasin korrigjimeve apo sistemimeve te gabimeve te viteve te kaluara, e te tjera te kesaj natyre.

68 – “Kuota te amortizimit dhe shuma te parashikuara te shfrytezimit”. Regjistron operacione jobuxhetore per institucione me drejtim ekonomik. Funksionimi i tyre nuk ndryshon me kete vendim

18. Ne faqen 63, klasa 7 “Te ardhurat sipas natyres” strukturohet ne nivel grupi llogarish si me poshte:

70. “Tatime”, 71 “Te ardhura jotatimore”. Keto grupe llogarish jane strukturuar ne nivel llogarie, nenllogarie dhe analize sipas klasifikimit buxhetor. Ne baze te dokumenteve justifikues te te ardhurave bashkengjitur titullit te te ardhurave te nxjerre nga urdheruesi ne keto llogari konstatohen ne kredi te ardhurat sipas natyres (operacione buxhetore), duke debituar llogarite e marrdhenieve me te tretet, llogarine 487 “Te ardhura te arketuara perpara titullit”, ose llogarite financiare sipas rastit.

72 “Grante korrent te pergjithshem”. Ne kete llogari perfshihen sponsorizime nga te tretet per funksionim si dhe financimet e perdorura nga buxheti i shtetit per funksionimin e institucionit ne debi te llogarise se disponibiliteteve ne Thesar.

73. “Ndryshimi i gjendjeve te inventarit” - Ky grup regjistron operacione jobuxhetore dhe zevendeson llogarine 703 “Ndryshimi i gjendjeve”. Funksionimi i llogarive te ketij grupi nuk ndryshon.

74. “Financime ne natyre”. Ky grup regjistron ne kredi vleren e financimit apo transferimit ne natyre te aktiveve qarkulluese te institucionit nga institucione brenda dhe jashte sistemit ne debi te llogarise 64 “Shpenzime ne natyre”(operacion jobuxhetor).

76. “Te ardhura financiare” - Ky grup llogarish eshte i strukturuar ne nivel llogarie, nenllogarie dhe analize sipas klasifikimit buxhetor. Ne baze te dokumenteve justifikues te te ardhurave bashkengjitur titullit te te ardhurave te nxjerre nga urdheruesi ne keto llogari konstatohen ne kredi operacionet buxhetore te te ardhurave financiare sipas natyres, duke debituar llogarite e marrdhenieve me te tretet, llogarine 487 “Te ardhura te arketuara perpara titullit”, ose llogarite financiare sipas rastit.

77. “Te ardhura te jashtezakonshme”. Ne kete grup llogarish regjistrohen operacione jobuxhetore qe i perkasin korrigjimeve apo sistemimeve te gabimeve te viteve te kaluara, etj te kesaj natyre.

78. “Punime per investime dhe rimarrje te shumave te parashikuara.” Regjistron operacione jobuxhetore. Funksionimi i tyre nuk ndryshon me kete vendim

19. Ne kapitullin “Mbyllja dhe kontrolli i regjistrimeve” pika 1, shfuqizohet.

20. Kapitulli “Mbyllja dhe kontrolli i regjistrimeve” pika 2, ndryshohet si vijon:

A. Hartimi i llogarise perfundimtare te vitit urshtrimor hartohet ne disa ekzemplare:

Organet e pushtetit vendor pergatisin:

- nje kopje per vete institucionin hartues,
- nje kopje per inspektorin e kontabilitetit ne rreth,
- nje kopje per zyren e statistikes,
- nje kopje per prefektoren ose qarkun,
- nje kopje ne Ministrine e Pushtetit Lokal.

Institucionet buxhetore nacionale te rrethit pergatisin:

- nje kopje per vete institucionin perkates,
- nje kopje per inspektorin e kontabilitetit ne rreth,
- nje kopje per statistiken.
- nje kopje ne institucionin qendror te linjes,
- nje kopje per prefektoren ose qarkun.

B. Institucionet qendrore hartojne pervec llogarise se tyre si institucion

edhe llogarine permbledhese te linjes ne disa ekzemplare:

- nje kopje ruhet ne institucionin qendror,
- nje kopje per statistiken,
- nje kopje per Ministrine e Financave,
- nje kopje per Kontrollin e Larte te Shtetit.

C. Inspektoret e kontabilitetit hartojne llogarine permbledhese per organet e pushtetit lokal te rrethit .

- nje kopje ruhet ne degen e Thesarit te rrethit;
- nje kopje dorezohet prane Ministrise se Financave.

- nje kopje per statistiken,
- nje kopje per prefektoren ose qarkun

NOMENKLATURA E LLOGARIVE TE PLANIT KONTABEL PUBLIK

KLASA 1

FONDE TE VETA, HUA DHE DETYRIME TE NGJASHME AFATGJATE

10 Fonde te veta

101 Fonde baze

1010 Fondi baze (ne momentin e integritit)

1011 Shtesa te fondit baze

1012 Pakesime te fondit baze

1013 Konsumi i aktiveve te qendrueshme

105 GRANTE TE BREND SHME KAPITALE

1050 Nga i njeiti nivel qeverisjeje

10500 Artikujt identifikojne burimin e fondit

105000 Artikujt identifikojne projektin specifik

1051 Nga nivele te tjera te qeverisjes

10510 Artikujt identifikojne burimin e fondit

105100 Artikujt identifikojne projektin specifik

1052 Kontribute te te treteve per investime

10520 Artikujt identifikojne burimin e fondit

105200 Artikujt identifikojne projektin specifik

1053 Te tjera

Grante te brendshme kapitale ne natyre

10590 Nga i njeiti nivel qeverisjeje

10591 Nga nivele te tjera qeverisjeje

10592 Te tjera ne natyre

106 GRANTE TE HUAJA KAPITALE

1060 Nga qeveri te huaja

10600 Artikujt identifikojne burimin e fondit

106000 Artikujt identifikojne projektin specifik

1061 Nga institucione nderkombetare

10610 Artikujt identifikojne burimin e fondit

106100 Artikujt identifikojne projektin specifik

1069 Grante te huaja kapitale ne natyre

10690 Nga qeveri te huaja

10691 Nga institucione nderkombetare

107 AKTIVE TE QENDRUESHME TE CAKTUARA NE PERDORIM

109 REZERVA NGA RIVLERESIMI I AKTIVEVE TE QENDRUESHME
TE TRUPEZUARA.

11 Fonde te tjera te veta

111 Fonde rezerve per shpenzime korrente

115 Caktim fondi per investime nga rezultati i funksionimit te vitit

116 te ardhura nga shitja e aktiveve te qendrueshme

1160 Shitja e aktiveve te patrupezuara.

116001 E drejta e koncesionit te pyjeve

116002 E drejta e peshkimit ne ujerat kombetare

116003 E drejta e shfrytezimit te mineraleve dhe karburanteve

116004 E drejta e shfrytezimit të ujit
116009 Të tjera

1161 Shitja e aktiveve të qendrueshme të trupezuara.
116101 Ndertesa
116102 Automjete
116103 Pajisje të përgjithshme
116104 Pajisje për qellime të vecanta
116199 Të tjera

1162 Shitja e tokës
116201 Urbane
116202 Rurale

1163 Shitja e rezervave shtetërore strategjike dhe emergjente
116301 Sheqer
116302 Grurë
116303 Vaj
116309 Të tjera

12. Rezultati i mbartur
121 Rezultati i mbartur i seksionit të funksionimit

13. Subvencione të jashtëzakonshme
130 Subvencione për investime të derdhura ose për të derdhur
138 Amortizimi i subvencioneve

14. PJESEMARRJE TË INSTITUCIONIT NË INVESTIME

140 – Pjesëmarrje në investime për llogari të institucionit
141 – Pjesëmarrje në investime për llogari të tjetër

15. Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime
16. HUAMARRJE E BRENDSHME DHE TË TJERA TË NGJASHME

BONO THESARI DHE TË TJERA LETRA ME VLERË (TË HYRA)

Bono thesari
Obligacione
Të tjera

161. TË TJERA HUAMARRJE TË BRENDSHME (TË HYRA)

1610 Hua nga i njëjti nivel qeverisjeje
1611 Hua nga nivele të tjera qeverisjeje
1612 Hua nga sistemi bankar

165 BONO THESARI DHE TË TJERA LETRA ME VLERË TË QEVERISE (TË DALA)

Bono thesari
Obligacione
Të tjera

166 HUAMARRJE TË TJERA TË BRENDESHME (TË DALA)

1660 Hua nga i njëjti nivel i qeverise
166000 Analizat duhet të identifikojnë burimin e huasë
1661 Hua nga të tjera nivele të qeverise

166100Analizat duhet te identifikojne burimin e huase
1662Hua nga sistemi bankar
166200 Analizat duhet te identifikojne burimin e huase

16. HUAMARRJE E HUAJ

170 QEVERI TE HUAJA (TE HYRA)

1700Italia
170000
1701Gjermania
170100
1702Greqia
170200
1703Kuvajt
170300
1704Japoni
170400
1705Kine
170500
1709Qeverite e huaja te tjera
170900

171 INSTITUCIONET NDERKOMBETARE (TE HYRA)

1710Banka Evropiane per rindertim dhe zhvillim (BERZH)
171000
1711Banka Europiane e Investimeve (BEI)
171100
1712Banka Boterore (IDA)
171200
1713Banka Islamike e Zhvillimit (IDB)
171300
1714Fondi Nderkombetar per Zhvillimin Bujqesor (IFAD)
171400
1715Organizata e Vendeve Eksportuese te Naftes (OPEC)
171500
1716Fondi Monetar Nderkombetar (FMN)
171600
1719Institucione nderkombetare te tjera
171900

172 HUAMARRJE TE TJERA (TE HYRA)

1720Bono
172000
1721Te-Tjera
172100

175 QEVERITE E HUAJA (TE DALA)

1750Gjermania
175000Identifiko marreveshjet individuale te huase.
1751Italia
175100Identifiko marreveshjet individuale te huase.
1752Greqia

175200Identifiko marreveshjet individuale te huase.
1753Kuvajt
175300Identifiko marreveshjet individuale te huase.
1754Japonia
175400Identifiko marreveshjet individuale te huase.
1755Kina
175500 Identifiko marreveshjet individuale te huase.
1759Qeveri e huaja te tjera
175900Identifiko marreveshjet individuale te huase.

175. INSTITUCIONET NDERKOMBETARE (TE DALA)

1760Banka Europiane per Rindertim dhe Zhvillim (BERZH)
176000Identifiko marreveshjet individuale te huase.
1761Banka Evropiane e Investimeve (BEI)
176100Identifiko marreveshjet individuale te huase.
1762Banka Boterore (IDA dhe IBRD)
176200Identifiko marreveshjet individuale te huase.
1763Banka Islamike e Zhvillimit (IDB)
176300Identifiko marreveshjet individuale te huase.
1764Fondi Nderkombetar per Zhvillimin Bujqesor (IFAD)
176400Identifiko marreveshjet individuale te huase.
1765Organizata e Vendeve Eksportuese te Naftes (OPEC)
176500Identifiko marreveshjet individuale te huase.
1766Fondi Monetar Nderkombetar (FMN)
176600Identifiko marreveshjet individuale te huase.
1769Institucione nderkombetare te tjera
176900Identifiko marreveshjet individuale te huase.

177HUAMARRJE TE TJERA TE JASHTME (TE DALA)

1770Bono
177000Identifiko marreveshjet individuale te huase.
1771Financime te tjera
177100Identifiko marreveshjet individuale te huase.

18 HUA ME AFAT TE MESEM DHE TE GJATE PA DERDHJE PARAPRAKE FONDESH

180 SUBVENCIONE TE PERVITSHME PER T'U DERDHUR

KLASA 2 AKTIVE TE QENDRUESHME

20 AKTIVE TE QENDRUESHME TE PATRUPEZUARA

201 Shpenzime dhe prime te emisionit ose rimbursimit te huave
202 Shpenzime per studime ose kerkime
205 Koncesione dhe te drejta te ngjashme, patenta, licenca, marka te drejta dhe vlera te tjera te ngjashme
209Amortizimi i aktiveve te patrupezuara

21 AKTIVE TE QENDRUESHME TE TRUPEZUARA

210 TERRENE
2101 Toka urbane
2102 Toka rurale
2103 Aktivitet natyrale

2104 Sistemime dhe rregullime te tokave
2105 Terrene te shtresave
211 PYJET, PLANTACIONET
2111 Pyjet
2112 Plantacione

212 NDERTIME
2121 Blerja e ndertesave te zyrave.
2122 Blerja e ndertesave rezidenciale
2127Blerje per konstruksione dhe ndertesa te tjera

213RRUGET, RRJETET DHE VEPRAT UJORE
2131 Rruget tokesore
2132 Ura
2133 Rrjetet (kanalizmet)
2134 Rezervuare

214INSTALIME TEKNIKE, PAJISJE, INSTRUMENTE DHE VEGLA PUNE
21401Pajisje dhe shpenzimet instaluese te telekomunikacionit
21402Orendi dhe pajisje mence
21403Pajisje qe sigurojne energji
21404Pajisje dhe instrumente laboratorike
21405Pajisje mjekesore dhe spitalore
21406Instalimi i sistemit te kompjuterave
21407Pajisje dhe instalimi i kondicionereve
21408Makineri printimi dhe grafimi
21409Pajisje per kontrollin e trafikut
21410Pajisje dhe instalime portuale (per portet)
21411Pajisje agrikulturore
21412Makineri dhe pajisje per minierat
21413Pajisje dhe makineri per kopshtarine
21414Pajisje dhe makineri per konstruksione (ndertime)
21415Pajisje per mbrojtjen ndaj zjarrit
21416Pajisje pastrimi per rruget
21417Pajisje per policine
21418Pajisje per sistemin e sigurimit
21419Pajisje audio-vizuale
21420Pajisje rezidenciale
21421Ashensore dhe vinça
21499Mjete dhe pajisje te tjera teknike

215MJETE TRANSPORTI

2151Motorçikleta
2152Makina
2153Autobuze
2154Kamione dhe mjete transporti te renda
2155Ambulanca
2156Mjete kunder zjarrit
2157Mjete policore
2159Mjete te tjera

216REZERVA SHTETERORE
2161Sheqer
2162Grure

2163Vaj
2169Stoqe te tjera

217KAFSHE PUNE E PRODHIMI
2171 Kafshe pune
2172 Kafshe prodhimi

218INVENTAR EKONOMIK
2181Orendi zyre
2184Fotokopje
2185Fakse
2186Pajisje kompjuteri
2187 Blerje te tjera pajisjesh për zyra

219 AMORTIZIME

Ndertesa
Ruge, rrjete, rezervuare
Makineri e pajisje
Mjete transporti
2197 Kafshe pune
2198 inventar ekonomik

23 SHPENZIME PER RRITJEN E AKTIVEVE TE QENDRUESHME

230 SHPENZIME PER RRITJEN E AKTIVEVE TE QENDRUESHME
TE PATRUPEZUARA

2300Studime fizibiliteti dhe pergatitje projektsh
230001Studime fizibiliteti
230002Pergatitje projektsh
2301Blerja e aktiveve te patrupezuara
230199Blerje te tjera të aktiveve te patrupezuara

231 SHPENZIME PER RRITJEN E AKTIVEVE TE QENDRUESHME
TE TRUPEZUARA

2310Blerja e tokes dhe aktiveve natyrale
231001Blerja e tokes urbane
231002Blerja e tokes rurale
231003Blerje të aktiveve natyrale
231004Sistemime dhe rregullime te tokave
2312Blerja e ndertesave dhe konstruksione te tjera
231201Blerje të ndertesave te zyrave.
231202Blerja e ndertesave rezidenciale
231299Blerje per konstruksione dhe ndertesa te tjera
2313Konstruksione te rrugeve, urave,rrjeteve, etj
231301Konstruksione te rrugeve
231302Konstruksione te urave
231303Konstruksione te rrjeteve
231304 Konstruksione te rezervuareve
2314Blerje e pajisjeve operacionale
231401Pajisje dhe shpenzime instaluese te telekomunikacionit
231402Orendi dhe pajisje mence
231403Pajisje qe sigurojne energji

231404Pajisje dhe instrumente laboratorike
 231405Pajisje mjekesore dhe spitalore
 231406Instalimi i sistemit te kompjuterave
 231407Pajisje dhe instalimi i kondicionereve
 231408Makineri printimi dhe grafimi
 231409Pajisje per kontrollin e trafikut
 231410Pajisje dhe instalime portuale (per portet)
 231411Pajisje agrikulturore
 231412Makineri dhe pajisje per minierat
 231413Pajisje dhe makineri per kopshtarine
 231414Pajisje dhe makineri per konstruksione (ndertime)
 231415Pajisje per mbrojtjen ndaj zjarrit
 231416Pajisje pastrimi per rruget
 231417Pajisje per policine
 231418Pajisje per sistemin e sigurimit
 231419Pajisje audio-vizuale
 231420Orendi dhe pajisje rezidenciale
 231421Ashensore dhe vinça
 231499Mjete dhe pajisje te tjera teknike
 2315Blerje e mjeteve te transportit
 231501Motorçikleta
 231502Makina
 231503Autobuze
 231504Kamione dhe mjete transporti te renda
 231505Ambulanca
 231506Mjete kunder zjarrit
 231507Mjete policore
 231599Mjete te tjera
 2316Sigurimi i Rezerves Shteterore
 231601Sheqer
 231602Grure
 231603Vaj
 231609Stoqe te tjera
 2317Kafshe pune e prodhimi
 231701Kafshe pune
 231702Kafshe prodhimi
 2318Blerje pajisjesh zyresh
 231801Orendi zyre
 231804Fotokopje
 231805Fakse
 231806Pajisje kompjuteri
 231899Blerje te tjera pajisjesh për zyra
 Rinovime, reabilitime dhe permiresime
 231910Toke, aktive natyrore
 231912Ndertesa dhe konstruksione te tjera
 231913Rruge, rrjete, etj
 231914Pajisje operacionale
 231915Mjete transporti
 231917Kafshe pune e prodhimi
 231918Pajisje zyresh

232 TRANSFERIMET KAPITALE

2320Transferimet kapitale tek nivele te tjera te qeverise se pergjithshme
 23201 Analiza duhet te identifikojë qellimin e transfertes

231010. Analiza duhet te identifikojë përfituesit e transferës
2321 Transferimet kapitale tek fondet ekstra-buxhetore
23211 Analiza duhet te identifikojë qëllimin e transferës
232110. Analiza duhet te identifikojë përfituesit e transferës
2322 Transferimet kapitale tek institucionet jo-fitimprurëse
23221 Analiza duhet te identifikojë qëllimin e transferës
232210. Analiza duhet te identifikojë përfituesit e transferës
2323 Transferimet kapitale tek ndermarrjet publike
23231 Analiza duhet te identifikojë qëllimin e transferës
232310. Analiza duhet te identifikojë përfituesit e transferës
2324 Transferimet kapitale tek institucionet financiare
23241 Analiza duhet te identifikojë qëllimin e transferës
232410. Analiza duhet te identifikojë përfituesit e transferës
2325 Transferimet kapitale tek ndermarrjet private
23251 Analiza duhet te identifikojë qëllimin e transferës
232510. Analiza duhet te identifikojë përfituesit e transferës
2326 Transferimet kapitale tek individët
23261 Analiza duhet te identifikojë qëllimin e transferës
232610. Analiza duhet te identifikojë përfituesit e transferës
2327 Transferimet kapitale jashtë shtetit
23271 Analiza duhet te identifikojë qëllimin e transferës
232710. Analiza duhet te identifikojë përfituesit e transferës

233 TAKSE MBI VLEREN E SHITUAR

234 KOSTO LOKALE

23 AKTIVE TE TRUPEZUARA TE DENTUARA

242 NDERTESA

243 RRUGE, RRJETE, REZERVUARE

244 MAKINERI E PAJISJE

245 MJETE TRANSPORTI

